



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 400.36516 dt. 27.07.2023

Bzuar në nenin 11, 12, pika 12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.7.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për Banim Social

I.

TË MIRATOHET vendimi për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për banim social nga ana e MMPHI-së, në lokacionin i cili është pronë e Komunës së Drenasit, dhe ka këto karakteristika dhe është në zonën kadastrale në Çikatovë të Re, në pjesën e ngastrës kad.326-4, me S= 42991 m², e cila sipas PZHK-së dhe Hartës Zonale është e planifikuar si tokë ndërtimore.

II.

Qëllimi për caktimin e këtij lokacioni ka të bëjë me realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për banim social, ku parcela e lartë cekura sipas PZHK-së dhe Hartës Zonale është e planifikuar për banim social.

III.

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin në RDPP.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

V.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kopja e planit dhe Çertifikata e njësisë kadastrale.

VI.

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit.

VII.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaku Hajdari

A r s y e t i m

Sipas kërkesës së MMPHI-së e cila edhe është donator i këtij projekti, të datës 24.07.2023, punimet për ndërtimin e objekteve të banimit social pritet të fillojnë shumë shpejt, andaj për tu kryer punët sipas standardeve të kërkuara është e domosdoshme të miratohet ky vendim dhe të caktohet lokacioni i shënuar më lartë, për arsye të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të banimit social.

Pra projekti për ndërtimin e objekteve të banimit sociale në zonën kadastrale Çikatovë e Re, do të financohet nga MMPHI, vlenë të ceket se në parcelen 326-4 janë të ndertuara edhe objektet aktuale kolektive të banimit social.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka caktuar ekipin profesional i cili ka përcaktuar dhe ka bërë matjet gjeodezike të lokacionit për ndërtimin e çerdhes në Komoran, sipas kërkesës së MMPHI-së ka përgaditur dokumentet e nevojshme gjeodezike.

Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë edhe Çertifikatat mbi të drejtat e pronës dhe kopja e planit për ku do bëhet caktimi i lokacionit.



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	02	02	14.08.23
PRISHTINË / A	No. 1		

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Trim Berisha, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimi 02 Nr. 00-36516/23, për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për Banim Social, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 27.07.2023

I nderuar kryetar Lladrovci,
I nderuar kryesues Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimin 02 Nr. 00-36516/23, për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për Banim Social, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 27.07.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Gllgocit:

KONFIRMIM

Vendimit 02 Nr. 00-36516/23, për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për Banim Social, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gllgocit, datë 27.07.2023.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit 02 Nr. 00-36516/23, për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për Banim Social, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gllgocit, konstatoi se:

Komuna e Gllgocit i ka të miratuara dokumentet e planifikimit hapësinor: Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës duke ju referuar Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Njëkohësisht, duke u bazuar në përmbajtjen dhe nenin II të vendimit për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve kolektive për Banim Social, miratuar nga Kuvendi Komunal i Gllgocit, lokacioni në fjalë sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës është i planifikuar për banim social, andaj si i tillë vendimi është në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinor.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Gllgocit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

